



FEDERATA ATLETIKE E KOSOVËS
KOSOVO ATHLETIC FEDERATION

Web page: www.fakosova.org

e-mail: kos@mf.iaaf.org

RREGULLORE E LEJES PËR PUNË (LICENCË) TË KLUBEVE TË ATLETIKËS

Në bazë të nenit 34 të Ligjit për sport të Kosovës dhe nenit 12 të Statutit të Federatës Atletike të Kosovës, në seancën e datës 16.01.2016 Bordit i FAK-ut sjell këtë:

RREGULLORE E LEJES PËR PUNË (LICENCË) TË KLUBEVE TË ATLETIKËS

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1.

(principet bazike të punës së klubeve të atletikës)

1. Kjo rregullore përcakton kushtet për funksionimin e klubeve të atletikës, si dhe kriteret për të marrë të drejtën për të punuar në fushën e atletikës në Kosovë.
2. Aktivitetet në fushën e atletikës, të cilat janë në përgjegjësinë e Federatës, mund t'i realizojnë vetëm klubet që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave joqeveritare pranë ministrisë gjegjëse dhe të cilat i plotësojnë standardet e përcaktuara në këtë Rregullore.
3. Klubet e atletikës mund të kryejnë aktivitete sportive dhe veprimtari sportive në qoftë se, në përputhje me Ligjin e sportit, rregulloret sportive dhe këtë rregullore kanë:
 - a) atlet të anëtarësuar ose të angazhuar me kontratë;
 - b) profesionistë të atletikës të angazhuar, në varësi të llojit të veprimtarisë;
 - c) të siguruar hapësirën e përshtatshme, respektivisht objekte sportive, pajisje dhe rekuizita atletike;
 - d) organizim të brendshëm të përshtatshëm dhe burime financiare për të marrë pjesë në aktivitetet atletike.
4. Punën profesionale në organizatat në atletikë, të cilat janë anëtare të Federatës Atletikës të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Federata), mund të kryhet vetëm profesionistët (ekspertët, specialistë) e atletikës të cilët i plotësojnë kushtet e përcaktuara me Ligjin për Sport dhe ata që kanë një leje pune (licencë) të parashikuar në këtë rregullore dhe Rregullat e Shoqatës Ndërkombëtare të Federatave Atletike (IAAF).
5. Eksperti i atletikës i cili ka një leje pune (licencë) – bazike ose profesionale mund të jetë i angazhuar në bazë të kontratës ose baza të tjera ligjore në vetëm 1 (një) klub atletike.
6. Eksperti i atletikës i cili ka një leje pune (licencë) - mjeshtër mund të jenë të angazhuar në bazë të kontratës ose baze tjetër juridike në një maksimum prej pesë (5) klube sportive, dhe kështu që në një klub është anëtarë i rregullt, ndërsa 4 (katër) të tjera i angazhuar në bazë kontraktuale si ekip konsulent apo këshilltar i ekipit të klubit atletik.
7. Puna profesionale arsimore (shkollore) në fushën e atletikës mund të kryhet vetëm nga profesionistët të cilët kanë arsimin e duhur apo nivelin e duhur të kompetencave në fushën e edukimit fizik dhe të sportit e përshkruar nga ligji i sportit në nomenklaturën e profesioneve sportiv dhe profesionet e Republikës së Kosovës.
8. Nëse specialisti sportiv është i angazhuar në punën me fëmijët, duhet të kenë një arsim të duhur në fushën e sportit dhe edukimit fizik (arsim fizik), në përputhje me ligjin.
9. Në selinë e klubit (dhe nëse është e mundur në zonat ku zhvillohen përgatitjet dhe ushtrimet e atletëve) duhet të shfaqet dukshëm licenca e klubit.
10. Klubi duhet të organizohet në mënyrë të tillë që të siguroj monitorim të vazhdueshëm mjekësor të të gjithë atletëve të regjistruar në klub.
11. Atlet nuk mund të përfshihen në aktivitetet sportive brenda klubit nëse nuk është vërtetuar nga mjeku, aftësia e tij për të kryer aktivitete fizike sportive, në përputhje me këtë sport.

LICENCIMI I KLUBEVE TË ATLETIKËS

Neni 2.

(llojet e licencës)

1. Licencimi i klubeve atletike që veprojnë në kuadër të FAK-ut është procedurë me të cilën:
 - zbatohet klasifikim i saktë i klubeve në relacion me vëllimin dhe llojin e aktiviteteve që dominojnë në punën e tyre dhe
 - kryhet kontroll i përhershëm i cilësisë së punës në fushën e atletikës.
2. Kjo Rregullore parashikon tri lloje të licencave për klubet atletike, dhe atë për:
 - a. Klubi bazik i atletikës - licencë të kategorisë së tretë,
 - b. Klubi i avancuar i atletikës - licencë të kategorisë së dytë,
 - c. Klubi prestigjioze i atletikës - licencë të kategorisë së parë.
3. Leja e punës (licenca) i lëshohet klubit atletik për një periudhë jo më të gjatë se një vit (për sezonin e garave kombëtare), me të cilën me datën që përfundon vlefshmërinë e lejes së punës (licencës) gjithmonë përkon me përfundimin e sezonit të garave kombëtare - të viti për të cilin është lëshuar leja e punës (licenca).

Neni 3

Klubi bazik i atletikës merr një licencë kur ai plotëson kushtet në vijim:

1. Regjistron në Federatë të paktën 8 (tetë) atlet për pjesëmarrje në gara prej të cilëve 3 duhet të jenë të kategorisë së pionierëve.
2. Merr pjesë në garat atletike në vend dhe jashtë vendit së paku me 8 atlet nga 4 gara secili brenda vitit.
3. Angazhon ekspertë sportiv si vijon:
 - Të paktën 1 (një) trajner me përvojë 8 vjeçare në sportin e atletikës dhe 1 (një) ndihmës,
 - plus 1 (një) trajner me përvojë 8 vjeçare në sportin e atletikës për çdo 8 (tetë) atletë të ri të regjistruar,
4. Siguron hapësirë adekuate me numër të caktuar të shtigjeve atletike apo arena, dhe atë si pronar i një objekti sportiv ose të lidhë një kontratë me një qendër sportive apo ndonjë sport tjetër apo institucion arsimor ose sportiv me të drejtën e përdorimit.
5. Siguron pajisje të përshtatshme sportive dhe rekuizita sportive në përputhje me standardet e përcaktuara sipas rregullave të garave për atletikë nga IAAF dhe FAK-u për të realizuar veprimtarinë e tij.
6. Kryen të gjitha detyrimet financiare në përputhje me vendimet e bordit të FAK-ut (të licencimit, kotizimit, regjistrimit etj.).
7. U përgjigjet kërkesave dhe komunikimeve me zyrën e FAK-ut për çfarëdo çështje që ka të bëjë me klubin e tij përmes postës elektronike.

Angazhimi i ekspertëve sportiv bëhet duke përdorë (përmbyllë) një marrëveshje mbi angazhimin profesional ose kontratës së punës, në përputhje me ligjin që rregullon sportin.

Nëse klubi ka punësuar më shumë ekspertë sportiv për të punuar me atletët është e detyrueshme që të përcaktojë një ekspert sportiv i cili bashkërendon dhe kontrollon punën e profesionistëve (ekspertëve) të tjerë sportiv.

Neni 4.

(Aktivitetet dhe të drejtat e klubit bazik të atletikës)

Licenca e vlefshme e klubit bazik të atletikës i mundëson që të realizoj aktivitetet e mëposhtme:

- Kryen trajnimin e fillestarëve dhe u mëson atyre shkathtësitë atletike;
- Kryen procesin e trajnimit në të gjitha disiplinat për të cilat ka ekspert dhe kushte hapësinore-teknike;
- Merr pjesë në të gjitha garat zyrtare atletike në vend dhe jashtë vendit;
- Bëhet organizator i mitingjeve të klubit, garave të shkollave dhe kroseve, dhe manifestimeve dhe garave të ngjashme në nivel dhe në bashkëpunim me pushtetin lokal.
- Të jetë organizator i garave në disiplina të ndryshme atletike, për të cilat merr miratimin e Bordit të Federatës Atletike të Kosovës.
- Të fitoj të drejtën e përfaqësimit të klubit të tij në kuvendin e FAK-ut me numrin e delegatëve që është përcaktuar në statutin e FAK-ut.

Neni 5

Klubi i avancuar i atletikës merr një licencë kur ai plotëson kushtet në vijim:

1. Regjistron në Federatë të paktën 16 (gjashtëmbëdhjetë) atlet për pjesëmarrje në gara prej të cilëve 5 duhet të jenë të kategorisë së pionierëve,
2. Merr pjesë në garat atletike në vend dhe jashtë vendit së paku me 16 atlet nga 4 gara secili brenda vitit.
3. Angazhon ekspertë sportiv si vijon:
 - Të paktën 1 (një) trajner me përvojë 8 vjeçare në sportin e atletikës dhe 2 (dy) ndihmës
 - plus 1 (një) trajner me përvojë 8 vjeçare në sportin e atletikës për çdo 8 (tetë) atletë të ri të regjistruar
4. Siguron hapësirë adekuate me numër të caktuar të shtigjeve atletike apo arena, dhe atë si pronar i një objekti sportiv ose të lidhë një kontratë me një qendër sportive apo ndonjë sport tjetër apo institucion arsimor ose sportiv me të drejtën e përdorimit.
5. Siguron pajisje të përshtatshme sportive dhe rekuizita sportive në përputhje me standardet e përcaktuara sipas rregullave të garave për atletikë nga IAAF dhe FAK-u për të realizuar veprimtarinë e tij.
6. Kryen të gjitha detyrimet financiare në përputhje me vendimet e bordit të FAK-ut (të licencimit, kotizimit, regjistrimit etj.).
7. U përgjigjet kërkesave dhe komunikimeve me zyrën e FAK-ut për çfarëdo çështje që ka të bëjë me klubin e tij përmes postës elektronike.
8. Ka në klubin e tij të paktën një (1) atlet me rezultat të 950 pikëve sipas tabelave poentuese të IAAF-së në disiplinat standarde të kampionatit botërorë dhe 1 (një) atlet me rezultat të 850 pikëve sipas tabelave poentuese të IAAF-së në disiplinat standarde të kampionatit botërorë.

Klubi i cili ka një (1) apo më shumë atlet të nivelit më të lartë garues të cilët arrijnë rezultate në vlerën e mbi 1000 pikëve sipas tabelës së performancës të IAAF në disiplinat standarde të kampionatit botërorë, një atlet i tillë i regjistruar do të ketë vlerën e tre (3) atletëve të regjistruar.

Klubi i cili ka një (1) apo më shumë atlet të nivelit më të lartë garues të cilët arrijnë rezultate në vlerën e mbi 900 pikëve sipas tabelës së performancës të IAAF, një atlet i tillë i regjistruar do të ketë vlerën e dy (2) atletëve të regjistruar.

Angazhimi i ekspertëve sportiv bëhet duke përdorë një marrëveshje mbi angazhimin profesional ose kontratë të punës, në përputhje me ligjin që rregullon sportin.

Nëse klubi ka punësuar më shumë ekspertë sportiv për të punuar me atletët është e detyrueshme që të përcaktojë një ekspert sportiv i cili koordinon dhe kontrollon punën e profesionistëve (ekspertëve) të tjerë sportiv.

Neni 6.

(Aktivitetet dhe të drejtat e klubit të avancuar të atletikës)

Licenca e vlefshme e klubit të avancuar të atletikës i mundëson që të realizoj aktivitetet e mëposhtme:

- Kryen trajnimin e fillestarëve dhe u mëson atyre shkathtësitë atletike;
- Kryen procesin e trajnimit në të gjitha disiplinat për të cilat ka ekspert dhe kushtet hapësinore-teknike;
- Merr pjesë në të gjitha garat zyrtare atletike në vend dhe jashtë vendit;
- Të jetë organizator i garave në disiplina të ndryshme (individuale) sportive, për të cilat merr miratimin e Bordit të Federatës Atletike të Kosovës.
- Të jetë organizator i garave ndërkombëtare për të cilat e merr lejen nga federata ndërkombëtare, përmes Federatës dhe Ministrisë përgjegjëse për sport.
- Të fitoj të drejtën e përfaqësimit të klubit të tij në kuvendin e FAK-ut me numrin e delegatëve që është përcaktuar në statutin e FAK-ut.

Neni 7

Klubi prestigjioz i atletikës merr një licencë kur ai plotëson kushtet në vijim:

1. Regjistron në Federatë të paktën 32 (tridhjetë e dy) atlet për pjesëmarrje në gara prej të cilëve 7 atlet duhet të jenë të kategorisë së pionierëve dhe 7 atlet të kategorisë së juniorëve,
2. Merr pjesë në garat atletike në vend dhe jashtë vendit së paku me 32 atlet nga 4 gara secili brenda vitit.
3. Angazhon ekspertë sportiv si vijon:
 - Të paktën 2 (dy) trajner me përvojë 8 vjeçare në sportin e atletikës dhe 3 (tre) ndihmës,
 - plus 1 (një) trajner me përvojë 8 vjeçare në sportin e atletikës për çdo 8 (tetë) atletë të ri të regjistruar,
4. Siguron hapësirë adekuate me numër të caktuar të shtigjeve atletike apo arena, dhe atë si pronar i një objekti sportiv ose të lidhë një kontratë me një qendër sportive apo ndonjë sport tjetër apo institucion arsimor ose sportiv me të drejtën e përdorimit.
5. Siguron pajisje të përshtatshme sportive dhe rekuizita sportive në përputhje me standardet e përcaktuara sipas rregullave të garave për atletikë nga IAAF dhe FAK-u për të realizuar veprimtarinë e tij.
6. Shlyen të gjitha detyrimet financiare në përputhje me vendimet e bordit të FAK-ut (të licencimit, kotizimit, regjistrimit etj.).
7. U përgjigjet kërkesave dhe komunikimeve me zyrën e FAK-ut për çfarëdo çështje që ka të bëjë me klubin e tij përmes postës elektronike.
8. Ka në klubin e tij të paktën një (1) atlet me rezultat të 1000 pikëve sipas tabelave poentuese të IAAF-së në disiplinat standarde të kampionatit botërorë, një (1) atlet me rezultat të 950 pikëve sipas tabelave poentuese të IAAF-së në disiplinat standarde të kampionatit botërorë dhe dy (2) atlet me rezultat të 900 pikëve sipas tabelave poentuese të IAAF-së në disiplinat standarde të kampionatit botërorë

Klubi i cili ka një (1) apo më shumë atlet të nivelit më të lartë garues të cilët arrijnë rezultate në vlerën e mbi 1000 pikëve sipas tabelës së performancës të IAAF në disiplinat standarde të kampionatit botërorë, një atlet i tillë i regjistruar do të ketë vlerën e tre (3) atletëve të regjistruar.

Klubi i cili ka një (1) apo më shumë atlet të nivelit më të lartë garues të cilët arrijnë rezultate në vlerën e mbi 900 pikëve sipas tabelës së performancës të IAAF, një atlet i tillë i regjistruar do të ketë vlerën e dy (2) atletëve të regjistruar.

Angazhimi i ekspertëve sportiv bëhet duke përdorë një marrëveshje mbi angazhimin profesional ose kontratë të punës, në përputhje me ligjin që rregullon sportin.

Nëse klubi ka punësuar më shumë ekspertë sportiv për të punuar me atletët është e detyrueshme që të përcaktojë një ekspert sportiv i cili koordinon dhe kontrollon punën e profesionistëve (ekspertëve) të tjerë sportiv.

Nëse klubi nuk ka udhëheqës të financave mund të angazhoj me kontratë një agjencion për kontabilitet dhe shërbim të financave për dokumentacionin e klubit.

Neni 8.

(Aktivitetet dhe të drejtat e klubit prestigjioz të atletikës)

Licenca e vlefshme e klubit prestigjioz të atletikës i mundëson që të realizoj aktivitetet e mëposhtme:

- Kryen trajnimin e fillestarëve dhe u mëson atyre shkathtësitë atletike;
- Kryen procesin e trajnimit në të gjitha disiplinat për të cilat ka ekspert dhe kushtet hapësinore-teknike;
- Të merr pjesë në të gjitha garat zyrtare atletike në vend dhe jashtë vendit;
- Të jetë organizator i garave në disiplina të ndryshme (individuale) sportive, për të cilat marrë miratimin e Bordit të Federatës Atletike të Kosovës.
- Të jetë organizator i garave ndërkombëtare për të cilat e merr lejen nga federata ndërkombëtare, përmes Federatës dhe Ministrisë përgjegjëse për sport.
- Të fitoj të drejtën e përfaqësimit të klubit të tij në kuvendin e FAK-ut me numrin e delegatëve që është përcaktuar në statutin e FAK-ut.

PROCEDURAT E LICENCIMIT TË KLUBEVE ATLETIKE

Neni 9.

(Procedura e Licencimit dhe përbërja e Komisionit për licencim)

1. Procedurat e Licencimit i kryer Komisioni për regjistrim të klubeve të FAK-ut (në tekstin e mëtejme Komisioni).
2. Komisionin me propozim të Sekretarit të Përgjithshëm të Federatës e emëron Bordi i FAK-ut.
3. Mandati i Komisionit është katër (4) vjet.
4. Punët teknike të Komisionit i kryen Sekretari i Komisionit të cilin e emëron Sekretari i Përgjithshëm i FAK-ut. Sekretar i Komisionit mbledhë dokumentacionin, mbajë evidencë për licencat e lëshuara dhe aplikacioneve të refuzuara, informon klubet me vendimet e Komisionit.
5. Anëtarët e Komisionit do të ketë të drejtë për kompensim të shpenzimeve për punën e tyre. Për lartësinë e kompensimit vendos Bordi i FAK-ut.

Neni 10.

(Dokumentacioni për licencimin e klubeve atletike)

1. Dokumentacioni i plotë në procesin e licencimit të klubeve atletike duhet të përmbajë:
 - Kërkesa për dhënien e licencës e plotësuar në formën e përcaktuar (Formulari A);
 - Certifikatën e regjistrimit të OJQ-së të klubit atletik;
 - Certifikatën e numrit fiskal të klubit atletik,
 - Listën e atletëve të regjistruar me numrat e librezës së identitetit të garave për vitin për të cilin kërkohet licenca (Formulari B);
 - Listën e profesionistëve të angazhuar sportiv (trajner, menaxher, etj.)
 - Fotokopje e kontratës mbi angazhimin e profesionistëve sportiv apo ekspertët në sport (menaxher, mjek) (Formulari C);
 - Dëshmi për hapësirë për kryerjen e aktiviteteve sportive (fotokopje të kontratës ose të akteve të tjera ligjore në përdorimin e hapësirës);
 - Fotokopje të dëshmimeve të detyrimeve të kryera financiare ndaj vendimeve të FAK-ut,
 - Dëshmi mbi pagesën e shpenzimeve të procesit të licencimit, të cilat janë paguar në xhirollogarinë e Federatës Atletikës të Kosovës (kopje e pagesës).
2. Formularët janë dhënë në web faqe dhe janë pjesë e kësaj rregulloreje

Neni 11

(Procedurat e licencimit dhe ankesat në vendim)

1. Procedura e dhënies së licencave (e lejes së punës) të klubit atletik, pavarësisht nga lloji i licencës, do të kryhet si më poshtë:
 - a. Klubi atletik i cili dëshiron të kryej aktivitete sportive dhe veprimtari sportive, kërkesën e tij për licencë me dokumentacionin përkatës (formularin e vërtetuar me vulën e klubit dhe e nënshkruar nga përfaqësuesi zyrtar i klubit dhe dëshmi të dokumentuara), i paraqet në zyrën e federatës, e cila zyrtarisht e përcjellë më pas tek Komisioni për procedurë të mëtutjeshme.
 - b. Dokumentet i shqyrton dhe analizon anëtarët e Komisionit në përputhje me standardet e përkrahura në këtë Rregullore. Nëse dokumentacioni nuk është i plotë, Komisioni do të informojë parashtruesin e kërkesës dhe e urdhëron atë për të përfunduar atë brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit. Në qoftë se deri në atë datë dokumentacioni nuk është i plotë, kërkesa për licencë refuzohet.
 - c. Komisioni do të shqyrtojë vetëm dokumentacionin e plotë brenda një periudhe prej 30 ditësh nga kompletimin e dokumentacionit.
 - d. Federata Atletike e Kosovës parashtruesit të kërkesës, të cilit i është miratuar licenca, i jep lejen për punë (licencën) të nënshkruar nga ana e personi i autorizuar.
2. Në rastet kur kërkesa është refuzuar, Komisioni do të informojë parashtruesin e kërkesës, duke shpjeguar arsyet për mos dhënien e licencës dhe një mjet juridik (shkresë).
3. Në vendimin e Komisionit parashtruesi i kërkesës i cili nuk ka marrë lejen për punë, ka të drejtë të ankohet bordit të FAK-ut dhe brenda 8 ditëve nga dita e pranimin të vendimit. Bordi i FAK-ut ose mund të refuzojë apo të pranojë ankesën. Nëse Bordi i FAK-ut e pranon ankesën, e obligon Komisionin të rishqyrtojë vendimin e saj.
4. Në rast se Komisioni sërish vendos që një aplikant për licencë nuk i plotëson kushtet për marrjen e licencës, aplikanti (parashtruesi) për licencë ka të drejtë të ankohet në Bordin FAK-ut dhe brenda 8 ditëve nga dita e pranimin të vendimit. Vendimi i Bordit të FAK-ut është përfundimtar.

Neni 12

(Pamja dhe përmbajtja e licencës lejes për punë të klubit atletik)

1. Leja e punës (licenca) e klubit atletik lëshohet (jepet) në letër 100 gram në format A-4. Ajo shtypet me shkronja të zeza në sfond të ndryshme të ngjyrosur të tillë si:
 - Licenca e rangut të tretë - klubi bazik i atletikës - sfond bronzi
 - Licenca e rangut të dytë - klubi i avancuar i atletikës - sfond argjendi
 - Licenca e rangut të parë - klubi prestigjioz i atletikës - sfond ari
2. Leja për punë e klubit atletik, detyrimisht duhet të përmbajë:
 - Emri i plotë i klubit në bazë të licencës së OJQ-së;
 - Emri i licencës – rangi i klubit;
 - Emërtimi i saktë i punëve të cilat klubi atletik në bazë të lejes mund të kryej brenda kuadrit të Federatës Atletike të Kosovës;
 - Periudha për të cilën është lëshuar (datën e lëshimit dhe data e skadimit);
 - Licenca duhet të përmbajë nënshkrimin origjinal të personit të autorizuar dhe vulën FAK-ut.

NDËRPRERJA E VLEFSHMËRISË RIPËRTRIRJA DHE MARRJA E LICENCËS

Neni 13

(Kohëzgjatja dhe përtëritja e licencës)

1. Leja për punë (Licenca) automatikisht ndërpritet të vlejë në datën e përfundimit të periudhës për të cilën është lëshuar.
2. Klubi atletik ka për detyrë që Komisionit për licencim të klubeve të FAK-ut t'i kërkoj zgjatjen e të njëjtës ose lëshim të tjetrës 30 ditë para skadimit të afatit të vlefshmërisë.
3. Klubi atletik i cili është licencuar dhe nëse nuk ka asnjë ndryshim në kushtet e angazhimit të atletëve ose profesionistëve sportive (ka kontratë shumëvjeçare), ose nuk ndryshon hapësirën ku i kryen aktivitetet sportive (ka kontratë shumëvjeçare) paraqet vetëm kërkesën për ripërtëritje të licencës (Formulari 1).
4. Komisioni në detyrën zyrtare mbi bazën e dokumentacionit zyrtar dhe regjistrimit i cili bëhet në Federatë vërteton nëse tek parashtruesi i kërkesës për licencë, e ka dokumentacionin në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje.
5. Nëse Komisioni për licencim brenda 30 ditëve nuk jep përgjigje në kohë në kërkesën e bërë apo tejkalon periudhën maksimale për licencë të mëparshëm të vlefshme, klubi atletik ka të drejtën për të vazhduar për të ndjekur aktivitetet që u janë lejuar në licencën e skaduar, deri në momentin e ripërtëritjes së licencës.

Neni 14

(marrja e licencës)

1. Leja e punës (licenca) i merret klubit atletik kur në bazë të dokumenteve zyrtare të mbajtura në regjistrat e Federatës vërtetohet se:
 - Gjatë punës në lëmin e atletikës, klubi kryen edhe detyra të cilat nuk janë të përshkruara në llojin e licencës së lëshuar;
 - Nëse vërtetohet më vonë se është dorëzuar dokumentacion i rremë apo i falsifikuar mbi të cilat është lëshuar leja për punë (licenca);
 - Në qoftë se gjatë afatit të licencës janë humbur kushtet e kërkuara për posedim të një licence të lëshuar siç kërkohet sipas kësaj rregulloreje;
 - Në qoftë se me aktivitetet e klubit dëmtohet reputacioni i Federatës Atletikës të Kosovës dhe përdoren mjete mashtruese dhe të paligjshme;
 - Në qoftë se klubi është suspenduar ose pushon së punuari me ndonjë bazë ligjore.
2. Në faqen zyrtare të Federatës Atletike të Kosovës publikohet emri i klubit atletik të cilit i

është marrë leja për punë (licenca), pas vendimit përfundimtar.

SHPENZIMET E LICENCIMIT

Neni 15.

(Pagesa e shpenzimeve)

1. Bordi i FAK-ut e përcakton shumën e shpenzimeve të lëshimit dhe ripërtëritjes së licencës.
2. Shpenzimet e licencimit, të paguhen Federatës atletike, kurse në rastet e veçanta, palët e treta (qeveritë lokale, sponsorët, donatorët, etj) në pajtim me ligjin.

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 16.

(Vlefshmëria e rregulloreve)

1. Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e publikimit të tabelën e shpalljeve dhe web faqes së FAK-ut. Me hyrjen e saj në fuqi pushon të vlejë të gjitha aktet normative të FAK-ut që kanë të bëjnë me licencimin, si dhe të gjitha rregullat dhe praktikat në lidhje me dhënien e licencës së klubeve atletike, të cilat ishin të aplikueshme në periudhën para miratimit të kësaj Rregulloreje.
2. Interpretimi i dispozitave të kësaj rregulloreje në mes të dy seancave të Bordit të FAK-ut e bënë Komisioni për licencimin e klubeve i FAK-ut së bashku me përfaqësuesin zyrtar të Federatës.

Neni 17.

(Periudha kalimtare)

1. Ditën e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, klubet atletike janë të obliguara që gjatë vitit kalendarik garues, por jo më vonë se në secilin vit të datës 20 shtator të plotësojnë procedurën për dhënien e licencës.

Prishtinë
16.01.2016

Kryetari i FAK-ut
Halil Sylejmani